



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/213
Datë: 15.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49, paragrafi 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhje e mbajtur më 15 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me Nr. Prot, 5096 e datës 12 korrik 2024 për konfirmimin e interesit të përgjithshëm publik në ushtrimin e aktiviteteve përkatëse nga Ndërmarrja Publike "Trepça" Sh. A.
2. Konfirmimi nga pika 1. e këtij Vendimi, bëhet me qëllim të aprovimit të lëshimit të licencës nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale për interes të përgjithshëm publik, duke marrë parasysh aspektin ekonomik dhe social të zhvillimit të "Trepça" Sh. A. në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Obligohet Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale për zbatimin e këtij Vendimi
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



7 korrik, 2024

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISË MINISTRY OF ECONOMY	
Nr. Prot. 01	No. Prot. 5096
Org. Unit 2	Date 12.07.24
PRISTINE A	

Për: Znj. Artane Rizvanolli


Ministre

Ministria e Ekonomisë, Qeveria e Republikës së Kosovës

Nga: Z. Habib Basholli

Kryesues i Bordit

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale



Lënda: Kërkesë për vendim të Qeverisë për licencimin e ndërmarrjes "Trepça" Sh. A

E nderuar znj. Ministre Rizvanolli,

Trepça Sh.A ka dorëzuar aplikacionin për Licencë të Shfrytëzimit për Miniera Metalike në Stantërg, Artanë, Bellobërd dhe Cërnac pranë Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me ç'rast ka kërkuar nga KPMM që ti lëshoj Licencë të Shfrytëzimit për Miniera Metalike dhe Leje për Aktivitete të Veçanta – Flotacion.

Neni 49 i ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, ka paraparë kushtet dhe kriteret për lëshimin e Licencës në interes të publikut për ndërmarrjet shoqërore dhe/ose ndërmarrjet publike, ku përcaktohet se Qeveria merr vendim me të cilin konfirmohet interesi i përgjithshëm publik i Republikës së Kosovës dhe vetëm pasi KPMM të pranojë një vendim të tillë nga Qeveria, mund të lëshojë Licencë në Interes të Publikut në përputhje me LMM-në.

Kjo kërkesë bazohet në nenin 49, paragrafi 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i cili e përcakton se KPMM, kërkon dhe merr një konfirmim, respektivisht një vendim nga Qeveria e Republikës së Kosovës me të cilin konfirmohet se ka arsye të forta dhe objektive për të konkluduar se lëshimi i kësaj Leje ose Licence në Interes të Publikut për ushtrimin e disa ose të gjitha aktiviteteve përkatës do të ishte në interesin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Duke e pasur parasysh se "Trepça" Sh.A është ndërmarrje me rëndësi të veçantë, jetike për mirëqenien sociale të punëtorëve dhe interesin e përgjithshëm publik në Republikës së Kosovës dhe duke e marrë në konsideratë rëndësinë e Licencimit të kësaj ndërmarrje, kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të nxjerr një vendim duke u bazuar në nenin 49 të LMM-së, me të cilin do ti hapte rrugë KPMM-së që të aprovojë Licencat e shfrytëzimit për Minerale Metalike për ndërmarrjen "Trepça" Sh.A.

Sipas nenit 49, paragrafi 5, kushte dhe konditat e licencës ose lejes në interes të publikut, duhet të jenë në përputhje me këtë ligj, me kusht që Licenca ose Leja në Interes të Publikut:

- Të përmbajë të gjitha kufizimet dhe kushtet shtesë të cilat KPMM i konsideron të arsyeshme dhe në interes të publikut sipas rrethanave;
- Nuk është e transferueshme dhe nuk mund të jetë objekt i pengut në asnjë rrethanë, prandaj neni 10 i këtij ligji nuk zbatohet për këtë lloj të Licencave dhe Lejeve;
- Ka kohëzgjatje prej jo më shumë se dy (2) viteve; dhe
- Të përjashtojë ndërmarrjen nga kërkesat e këtij ligji për deponimin e garancisë së ekzekutimit.

Kërkesa është e bazuar në Ligjin Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin 05/L-120 për Trepçën. Neni 5, paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, përcakton se *"Trepça Sh.A, hulumton dhe shfrytëzon resurset minerale në bazë të licencës për hulumtim dhe shfrytëzim të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës"*.

Paraprkishtë ju falënderojmë për përmendjen dhe bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,


 Dr.Habib Basholli
 Kryesues i Bordit
 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale



Rr. Armend Daci Nr.1
 Prishtinë, Kosovë
 Tel: +381 (38) 240 252
 Fax: +381 (38) 245 844
 E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
 Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
 Skupština Kosova
 Assembly of Kosovo